



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.140 dt.30.10.2001

**PER
KALIM NE FOND BANESE DHE PER PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV
PER BODRUMET E PAPERIVATIZUARA**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.30.10.2001 pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve Njerëzore “Për kalim në fond banese dhe për pajisje me autorizim definitiv për bodrumet e paprivatizuara”, mbështetur në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, pika e, VKM-së Nr.49 dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.9 dt.25.11.1992 “Për marrjen e bodrumeve dhe lirimin e sipërfaqeve të tepërta të banimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.43 dt.09.05.1995 “Për kalimin në fond banese për bodrumet”, si dhe Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.1440 dt.04.04.1996 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”

V E N D O S I

1. Të kalojë në fond banese bodrumi në adresën e mëposhtme dhe të bëhet pajisja me autorizim definitiv si më poshtë:

1-Lazër Shkëmbi – për bodrumin 2 dhoma në adresën Rr.Ali Demi, pll.nr.6, shk.3
2. Destinacioni i përdorimit të bodrumit të jetë banese

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për të zbatuar këtë vendim
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

